



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Elbasan, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2017

**LËNDA:** Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

**AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK**

**TIRANE**

**NJOFTIMI I FITUESIT**

Nga: **Bashkia Elbasan** adresë: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Për: “**Be - is**” sh.p.k me adresë: Lagjja nr.1, pallati Metalurgu, hyrja nr.1, Kukës.

Për: **Aurora construksion** ” sh.p.k me adresë: Bulevardi Zogu i Parë, Pallati pranë Fakultetit të Shkencave, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “**Procedurë e Hapur**”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Reabilitimi urban i sheshit “Zaranika” dhe Bulevardi “Aqif Pasha” (segmenti nga Kryqezimi 1 Maji- Ura e Zaranikes) -Faza IV**”, me fond limit: **111.922.111** (njëqind e njëmbëdhjetëmillion e nëntëqind e njëzet e dymijë e njëqind e njëmbëdhjetë) **lekë** (pa tvsh), vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit dhe me afat përfundimin e punimeve **6 muaj** nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike  
**[22.05.2017 ] [20 ]**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- “**Shpresa**” sh.p.k me Nipt: L 48709501 U & “**Beladi**” sh.p.k. me Nipt: J 62903254 C

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **89.291.381** (tetëdhjetë e nëntëmillion e dyqind e nënëtëdhjetë e njëmijë e treqind e tetëdhjetë e një) lekë (pa tvsh) dhe me vlerë kontratë prej **107.149.657** (njëqind e shtatëmillion e njëqind e dyzet e nëntëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë (me tvsh).

- “**Kacdedja**” sh.p.k me Nipt: K 51712017 A & “**Company Riviera 2008**” sh.p.k. me Nipt: K 81716011 V

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **89.549.386** (tetëdhjetë e nëntëmillion e pesëqind e dyzet e nëntëmijë e treqind e tetëdhjetë e gjashë) lekë (pa tvsh) dhe me vlerë kontratë prej **107.459.263** (njëqind e shtatëmillion e katërqind e pesëdhjetë e nëntëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë (me tvsh).

- “**Shendelli**” sh.p.k.. me Nipt: K 07924803 N

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **0** (zero) lekë (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **0** (zero) lekë (me tvsh).

- “**Be - is**” sh.p.k. me Nipt: K 71412003 A & “**Aurora construkzion**” sh.p.k me Nipt: K 02017003 I

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **98,753,741** (nëntëdhjetë e tetëmillion e shtatëqind e pesëdhjetë e tremijë e shtatëqind e dyzet e një) lekë (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **118,504,489** (njëqind e tetëmbëdhjetëmillion e pesëqind e katërmijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë (me tvsh).

- “**Vellezerit Hysa**” sh.p.k me Nipt: K 12911201 C

**Ofertues të skualifikuar janë katër operatorë.**

- “**Victoria Invest**” sh.p.k. me Nipt: K 32712206 U
- “**Alko – Impex General Construction**” sh.p.k. me Nipt: K 9132602 B
- “**Vëllezërit Hysa**” sh.p.k. me Nipt: K 12911201 C
- “**Trema Engineering 2 Shpk.**” me NIPT K 21401004 R & “**Rruga Ura Asfaltike nr 2 sh.a**” me NIPT J 629042640 O

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

**1. “Victoria Invest ” sh.p.k. skualifikohet për arsye se gjatë shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave u konstatua se:**

- a) Në lidhje me kriterin 6. Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, operatori nuk e përbush këtë kriter. Në DST percaktohet se : **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve.** Nisur nga kjo e drejtë Autoriteti kontraktor ka verifikuar nëse subjekti i disponon mjete e paraqitura sipas shtojces 9 në adresën sheshi 4 ish kombinati metalurgjik, adresë e përcaktuar në deklaratën e drejtueses ligjore të shoqërisë Z.Fatmir Kuci. Nga verifikimi i datës 10.07.2017 rezultoi se shumica e mjeteve të kërkova për realizmin e kontratës dhe të deklaruara në shtojcen 9, nuk ishin në adresën e deklaruar. Kjo e dokumentuar me procesverbal.
- b) Në lidhje me kërkesat e pikës 9 të kapacitetit teknik: “ Operatori ekonomik ka paraqitur një vetdeklarim nga i cili rezulton se ka disa punë në proces, që i angazhojnë një pjesë të mirë të kapaciteteve organizative, makinerive , pajisjet e asete të tjera fizike, si dhe inxhinjerët pjesë të stafit teknik të nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Duke iu rferuar dhe listpagesave në të cilat numri më i madh i të punsuarëve janë shofer, roje, puntorë pastrimi, autoriteti kontraktor del në përfundimet se fuqia puntore që ka në dispozicion subjekti ekonomik nuk është e mjaftueshme për të siguruar besushmërinë në realizimin me suksese dhe në kohë të kontratës. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, Kvo gjykon se operatori ekonomik duke pasur disa kontrata në të njëjtën kohë në proces nuk i ka kapacitet për realizimin me sukses të kontratës. Në përputhje ” Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “ Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”. operatori ekonomik skualifikohet.

**2. “Alko – Impex General Construction” sh.p.k. skualifikohet për arsye se gjatë shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave u konstatua se:**

- a) Në përbushje të kërkesave të shkronjes a, të pikës 2.1 kapaciteti ligjor, Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokument që vërteton se subjekti Meme ALKO-IMPEX General Construction sh.p.k ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për çdo vend ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitet 2016 dhe 2017. Në përbushje të kërkesave të shkronjës b, të pikës 2.1 kapaciteti ligjor, Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur një deklarat me shkrim nga administratori

se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitet 2016 dhe 2017. Në lidhje me kriterin se duhet të paraqesë: Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar detyrimet fiskale dhe detyrimet e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga Administrata Tatimore. Për subjektin Meme ALKO-IMPEX General Construction sh.p.k ka paraqitur një dokument i cili pavarësisht se është i noterizuar nuk përmban asnjë vule institucioni publik nga i cili është lëshuar.

**Operatori ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.**

- b) Në lidhje me kriterin: Operatori ekonomik të paraqesë Kopjet e çertifikuara të bilanceve për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse e të konfirmuara nga ky autoritet. Për subjektin Meme ALKO-IMPEX General Construction sh.p.k ka parqitur “Bilanci 2015”, që shoqërohet nga Vërtetimi notarial i cili unifikon kopjen me origjinalini, në të cilin nuk specifikohet emërtimi i dokumentit që verifikon dhe numri i fletëve. Legalizimi i dokumentacionit që lëshohet nga institucionet analoge të atyre Shqiptare bëhet në zyrat përkatëse mbi origjinalin e dokumentit ose mbi aktin notarial. Por në këtë rast ajo çka vërteton akti notarial nuk përputhet me dokumentacionin që shoqëron. Për sa më sipër ky dokument nuk konsiderohet ligjor dhe nuk merret në shqyrtim. **Operatori ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.**
- c) Në përbushje të kërkesave të shkronjës a, b, c të pikës 2.2 kapaciteti ekonomik dhe finiar për subjektin Meme ALKO-IMPEX General Construction sh.p.k. nuk ka paraqitur asnjë dokument. **Operatori ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.**
- d) Në përbushje të kërkesave të pikes 1, të 2.3 kapacitetit teknik operatori ekonomik ka paraqitur kontratën “Zgjerimi i Rrugës Regionale (R102) Komoran –Skenderaj.....”. për të cilën nuk ka paraqitur formular vlerësimi sipas shtojcës të kërkuar në DST. Kontrata është kopje e dokumentit original dhe shoqërohet me një vërtetim notarial. Por në këtë rast akti notarial nuk përmban të dhënat ligjore të domosdoshme për të verifikuar që vërteton njesimin me origjinalin të dokumentacionin që shoqëron. Për sa më sipër ky dokument nuk konsiderohet ligjor dhe nuk merret në shqyrtim. Ndërsa objekti i kontraktuar me Bashkinë Librazhd në përputhje me % e pjesmarrjes nuk plotëson vlerën e punëve të ngjashme. **Operatori ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.**
- e) Në lidhje me kërkesat e pikës 4 të kapacitetit teknik listapgesat e vitit 2016 dhe Janar – Prill 2017 të paraqitura nga dega e shoqërisë në Shqipëri nuk jane të konfirmuara nga Administrat Tatimore si dhe është kërkuar në DST. Listpagesat e vitit 2016 dhe Janar- prill 2017 e subjektit Meme ALKO-IMPEX General Construction sh.p.k nuk merren në konsideratë. Këto dokumenta përbajnë 4 fletë ndërkohe që vërtetimi notarial unifikon vetëm 2 fletë A4 pa përcaktuar se cili është ky dokument. Operatori ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.
- f) Operatori ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me kërkesat e pikës 5.1 dhe 5.2 të kriteve teknik pasi në përbushje të këtij kriteri nuk ka paraqitur kontrata pune si dhe kërkohet në DST.
- g) Në lidhje me kriterin 6. Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës operatori nuk e përbush këtë kriter. Në DST përcaktohet se: **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve.** Nisur nga kjo e drejtë Autoriteti kontraktor ka verifikuar nëse subjekti i disponon mjetet e paraqitura sipas shtojcës 9 në

adresën Rruga: Reshit Petrela, kompleksi Usluga” adresë e përcaktuar në deklaratën e drejtueses ligjore të shoqërise Z.Arber Abazi. Nga verifikimi i datës 10.07.2017 rezultoi se shumica e mjeteve të kërkua rë realizmin e kontratës dhe të deklaruara në shtojcën 9, nuk ishin në adresën e dekluarar. Kjo e dokumentuar me procesverbal.

### 3. “Vellezërit Hysa” sh.p.k. skualifikohet për arsyen se gjatë shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave u konstatua se:

a) Në lidhje me kërkesat e pikës 5.1 të kapacitetit teknik Operatori ekonomik ”Në përbushje të këtij kriteri për: Punonjës hidraulik me kualifikime teknike nga IQT (ISHTI-sot) 2 (dy), ka paraqitur dokumentacionin e Marjus Hysës i cili nga listpagesat e sig të shoqërisë rezulton të jetë shofer.

b) Në lidhje me kërkesat e pikës 5 operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin për dy inxhinjere ndërtimi por asnjëri prej tyre nuk është i profilit transport infrastrukturë siç dhe kërkohet në DST.

c) Në lidhje me kërksesat e pikës 9 të kapacitetit teknik: “Operatori ekonomik ka paraqitur një vetdeklarim nga i cili rezulton se ka disa punë në proces, që i angazhojnë një pjesë të mirë të kapaciteve organizative, makinerive, pajisje e asete të tjera fizike, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Në kërkesat e DST-ve është kërkuar një numër prej 110 punojësish. Nga vërtetimet e autoriteteve përkatëse rezulton se numri mesatar është 122 punonjës ndërkohë që vetëm në kontratën që ka në vazhdim me Bashkinë Elbasan, me objekt “Sistemim-Asfaltim rruga Broshkë dhe ura mbi lumin Shkumbin” ky subjekt ka të angazhuar 105 punonjës.

Gjithashtu referuar Buletinit të APP nr.28 datë 17. Korrik 2017 Operatori ekonomik “Vellezërit Hysa” në datë 6.7.2017 ka lidhur me autoritetin kontraktor Bashkia Kavaj 2 kontrata me objekt “RIKONSTRUKSION I RRUGES KLA&XHU-SHETITORE QENDER GOLEM” dhe kontratën me objekt Bulevardi “JOSIF BUDO” që i shtohen objekteve të deklaruara nga subjekti në kuadër të pikës 2, duke ulur akoma më shumë kapacitetet e tij për përbushjen e kontratave.

d) Në lidhje me kriterin 6. Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës operatori nuk e përbush këtë kriter. Në DST përcaktohet se: Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve. Nisur nga kjo e drejtë Autoriteti kontraktor ka verifikuar nëse subjekti i disponon mjetet e paraqitura sipas shtojces 9 në adresën njësia administrative Klos, pranë lumit Devoll, adresë e përcaktuar në deklaratën e drejtueses ligjore të shoqërisë Z.Kujtim Hysa. Nga verifikimi i datës 14.07.2017 rezultoi se disa nga mjetet e kërkua rë realizmin e kontratës, nuk ishin në adresën e dekluarar. Kjo e dokumentuar me procesverbal.

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme

teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, Kvo gjykon se operatori ekonomik duke pasur disa kontrata në të njëjtën kohë në proces nuk i ka kapacitet për realizimin me sukses të kontratës.

Në përputhje ” Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij nen, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...” operatori ekonomik skualifikohet.

**4. “Trema Engineering 2 Shpk.” & “Ruga Ura Asfaltime nr 2 sh.a”.** skualifikohet për arsy se gjatë shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave u konstatua se:

1. Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit Nr. 1206 Rep Nr.193/2 Kol date 16.05.2017 ,të operatoreve ekonomike “Trema Engineering 2 Shpk.” dhe “Ruga Ura Asfaltime nr 2 sh.a”, punët janë ndarë konkretisht :

- Shoqëria “Trema Enginerring 2Sh.p.k” 51% e vleres së ofertuar
- Shoqëria “Ruga Ura Asfaltime nr 2 sh.a.” 49 % e vlerës së ofertuar

Vlera e punimeve të deklaruara per t'u kryer nga shoqëria ‘‘Ruga Ura ASfaltime nr 2’’ sh.a, referuar preventivit te ofertes se ketij bashkimi operatoresh , shkon në vlerën 79,634,668 (shtatëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e tridhjetë e katërmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë)leke , vlerë kjo, e cila në raport me vlerën totale të ofertës 111,423,080 (njëqind e njëmbëdhjetë e një milion e katërqind e njëzet e tre mijë e tetë hjetë) leke , përben 71 % të punimeve totale. Përqindje kjo më e lartë se 49% të dekluaruar në marrëveshjen e bashkëpunimit.

Ne piken 2 te nenit 74 te VKM-se nr.914 date 29.12.2014, i ndryshuar percaktohet se : “Para dorezimit te ofertes, bashkimi duhet te krijohet zyrtarisht, me një marreveshje te noterizuar, ku te percaktohen perfaqesuesi i grupit, perqindja e pjesemarrjes se punes/sherbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, qe do te kryeje secili nga anetaret e ketij bashkimi.Pas krijimit te bashkimit te operatoreve ekonomike, anetaret e bashkimit caktojne me prokure perfaqesuesin e tyre per dorezimin e ofertes .....

Duke qene se perqindjet e pjesemarrjes percaktohen nga zerat konkret te punes qe eshte angazhuar te kryej secili nga antaret e bashkimit te operatoreve, referuar pikes 3, te nenit 74 te VKM-se nr.914 date 29.12.2014, i ndryshuar percaktohet se “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje “ perqindja e pjesemarrjes nuk eshte ajo e percaktuar ne aktmarrveshje Nisur nga sa me siper kjo aktmarreveshje nuk eshte vlefshme .

Nese i referohemi perm bushjes se kritereve te tjera ne perputhje me % e pjesemarrjes operatori ekonomik “Ruga Ura ASfaltime nr 2” sh.a, i cili duhet te jete kryesuesi bashkimit te operatoreve, shume nga kriteret e DST-ve nuk plotesohen.

2. Për kryerjen e punimeve të deklaruara në marrëveshjen e bashkëpunimit, shoqëria "Ruga Ura ASfaltimë nr 2", duhet të disponojë pikat e liçensave **NS-9 A** (Punime strukturore speciale) dhe **NS-10 A** (Shtresa dhe mbistruktura speciale), pika liçensash të cilat nuk i disponon.

Në nenin 46, pika 1, gërmë "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimi: "1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:" aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Ne perputhje " Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij nen, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...". operatori ekonomik skualifikohet.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin:  
Operatorin ekonomik "**Be - is**" sh.p.k me adresë: Lagjja nr.1, pallati Metalurgu, hyrja nr.1, Kukës, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **119,220,882** (njëqind e nëntëmbëdhjetëmillion e dyqind e njëzetëmijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy lekë (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkise Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve)**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **20** (njëzet) **ditëve** nga dita e marrjes/publikimit së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimet Publike", i ndryshuar.

**Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 18.07.2017**

**Ankesa nuk ka patur.**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
OSE PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ**  
**Zv.Kryetari**  
**Ervin Saracı**

